

**V E N D I M**  
**Nr.520, datë 14.11.1999**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.192, DATË  
20.3.1998 "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË  
PRIVATIZOHET DHE PROCEDURAT E SHITJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, me propozimin e Ministrisë së Financave,

**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, pika 14 e kapitullit III ndryshohet si vijon:

"Blerësi është i detyruar të bëjë pagesën në lekë të pjesës së mbetur të çmimit të arritur në ankand, kur 20 për qind e vlerës së objektit është paguar në lekë. Nga pagesa 20 për qind e vlerës fillestare të objektit të paguar në lekë, zbritet shuma e llogaritur, në masën 5 për qind të vlerës fillestare të objektit, e cila mbahet si e ardhur për AKP-në".

2. Ky vendim i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 20.3.1998.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**